


# Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë Trendet, sfidat dhe mundësitë



## Hyrje

Të udhëhequr nga ideja e promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha nivelet e politikë-bërjes, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka mbledhur të dhëna për dizajnimin e një databaze të Treguesve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (TZHQ). Thelbi i kësaj databaze të dhënash është të zbulohen trendet, sfidat dhe mundësitë nga perspektiva e tri shtyllave kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm në vend, përkatësisht shtylla ekonomike, sociale dhe ajo mjedisore.

Identifikimi dhe rreshtimi i këtyre indikatorëve është i rëndësishëm për të pasur një pasqyrë të qartë të progresit të shënuar në nivel shtetëror në lidhje me çështjet kyçe që janë të rëndësishme në kuadër të këtyre tre sektorëve. Kjo databazë e TZHQ-ve përmban më shumë se 150 tregues, të klasifikuar në 19 tema kryesore dhe 47 nën-tema. Përzgjedhja e treguesve është bërë përmes një kombinimi të TZHQ-ve të identifikuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në kombinim me treguesit tjerë të identifikuar në bazë të të dhënave të siguruara nga Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS) dhe burime tjera të besueshme të të dhënave.

### Temat e TZHQ-ve

Sociale	Mjedisore	Ekonomike
Barazia Shëndetësia Arsimi Banimi Siguria Popullsia Benefitet sociale Migrimi	Atmosfera Toka Uji i pastër Bio-diversiteti	Buxheti Struktura ekonomike Trendet e konsumit dhe prodhimit Punësimi Ndërmarrësia Detyrimet dhe tatimet Energjia

Angazhimi i INDEP-it në këtë drejtim është gjithashtu në përputhje me rezultatet kryesore të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedis dhe Zhvillim të mbajtur më 1992, ku u përcaktua që TZHQ-të do të mund të ishin mjeti strategjik për të ndihmuar qeveritë dhe shtetet që të angazhohen në vendim-marrje të informuar në sektorë të ndryshëm të politikë-bërjes, me fokus të posaçëm tek promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

Si pasojë, Kapitulli 40 i Agjendës 211, plani i veprimit që u miratua në Konferencën e OKB-së për Mjedis e Zhvillim në Rio de Zhaneiro më 1992, i bën thirrje të posaçme shteteve, qeverive e organizatave joqeveritare që të angazhohen për të zhvilluar TZHQ-të si mënyrë për sigurimin e një baze të shëndoshë për vendim-marrje të informuar në afat të gjatë.

Për më tepër, më 25 shtator 2015, vendet e të gjithë botës miratuan një listë prej 17 qëllimesh drejt sigurimit të prosperitetit, luftimit të varfërisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Pasi secili prej qëllimeve pritet të realizohet në 15 vitet e ardhshme, ky qëllim kërkon përkushtimin e përbashkët të të gjitha palëve të angazhuara në proces. Përkundër faktit që Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, ajo aspiro të bëhet anëtare si dhe është zotuar të përmbushë kërkesat që dalin nga legjislacioni (Acquis) i Bashkimit Evropian, prandaj përkushtimi i saj drejt krijimit të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm bëhet tashmë imperativ.

Si përfundim, INDEP ka vendosur të përkushtohet në këtë drejtim dhe të përpilojë një listë TZHQ-sh, gjë që nuk është bërë më parë, e kështu të sigurojë një platformë të cilës do të mund t'iu referoheshin palët e interesuara dhe ato të përfshira, gjë që në anën tjetër mund të shërbejë si vegël efektive për të monitoruar performancën e përgjithshme të zhvillimit të qëndrueshëm në vend.

### Metodologjia

Duke marrë parasysh fushëveprimin e gjerë të treguesve të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm si dhe mungesën e vazhdimësisë të disa publikimeve të Agjencisë Kosovare të Statistikave (AKS), ka qenë e domosdoshme që të merren parasysh të dhëna nga disa burime të tjera të besueshme; të brendshme e të jashtme.

Përkundër mangësive, AKS-ja mbetet epiqendra e të dhënave të disponueshme, si dhe autoritet shtetëror përgjegjës kur bëhet fjalë për raportimin e tyre. Pra, ky raport, me përjashtim të disa treguesve që nuk kanë qenë në dispozicion, ka shfrytëzuar të dhënat që janë mbledhur nga vetë AKS-ja. Të dhënat që nuk kanë qenë të disponueshme nga autoriteti shtetëror janë mbledhur nga burime të tjera të besueshme e legjitime. Në vijim është dhënë tabela e burimeve të të dhënave:

Databazat e përdorura	Agjencia Statistikore e Kosovës
	Euromonitor Passport
	Banka Botërore
	Ministria e Bujqësisë
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
	Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit
	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Tabela 1: Burimet e të dhënave

Të dhënat në këtë raport janë mbledhur për periudhën 2008-2015. Periudha e analizës përkon me periudhën që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe ekzistimi i saj si njësi e pavarur shtetërore.

Është me rëndësi të nënvizohet që çdo kategori e të dhënave përplotësohet me një pjesë ku ofrohen komentet në lidhje me trendet më interesante.

Përfundimisht, edhe pse ideja fillimisht ishte që të mblidheshin të dhënat për tremujorë, si pasojë e disponueshmërisë së ulët të statistikave, TZHQ-të për Kosovën do të publikohen një herë në vit.

## TZHQ-të – dimensioni social

Derisa dimensionet ekonomik dhe ai mjedisor i zhvillimit të qëndrueshëm janë diskutuar gjerësisht dhe përgjithësisht janë të kuptueshme në qarqe shoqërore, qëndrueshmëria sociale mbetet një prej aspekteve më të mjegullta në definicion, pasi që është më së paku e elaboruar në përgjithësi. Sipas listës së TZHQ-ve të përzgjedhura, qëndrueshmëria sociale ka të bëjë me temat si: barazia, shëndetësia, arsimi, banimi, siguria, popullsia, beneficionet sociale dhe migrimi.

Qëndrueshmëria sociale është aspekti më së paku i përkufizuar dhe më së dobëti i kuptuar i qasjes ndaj qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Qëndrueshmëria sociale ka gëzuar shumë më pak vëmendje në debatin shoqëror në krahasim me qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekonomike.

Megjithatë, diskursi në publik është i tillë që të gjitha dimensionet e qëndrueshmërisë kanë në vete elementin social, pasi që në fakt qëndrueshmëria sociale është e ngulitur në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Së voni, organizata e institucione të ndryshme kanë provuar të definojnë qëndrueshmërinë sociale. Një prej definicioneve më gjithëpërfshirëse është ai që është dhënë nga Social Life (Jeta Sociale), sipas të cilit, qëndrueshmëria sociale është «proces për krijimin e vendeve të qëndrueshme, të suksesshme që promovojnë mirëqenien, duke kuptuar se çfarë kërkojnë njerëzit nga vendet në të cilat punojnë e jetojnë. Qëndrueshmëria sociale kombinon projektimin e aspektit fizik me projektimin e botës sociale – infrastrukturën për përkrahje të jetës shoqërore e kulturore, të mirat sociale, si dhe sisteme për angazhim të qytetarëve, si dhe hapësirë ku njerëzit dhe vendet evoluojnë”.

## Barazia

<b>Treguesit sociale</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Varfëria</b>	<i>Përqindja e popullsisë nën kufirin e varfërisë</i>	39%	34.50%	29.20%	29.70%	28.10%	27.40%	26.65%	25.80%
	<i>Indeksi Gini për pabarazinë në të ardhura</i>	/	31.78%	33.25%	27.83%	29.40%	26.71%	/	/
	<i>Shkalla e papunësisë</i>	47.50%	45.40%	38.20%	34.20%	30.90%	30%	35.3%	32.9%
<b>Barazia gjinore</b>	<i>Raporti i pagës mesatare të gruas me pagën e burrit</i>	/	/	/	/	/	/	/	/

Në diskursin e përgjithshëm, si dhe atë ekonomik, barazia ka të bëjë me cilësinë e të qenit i paanshëm dhe i drejtë. Në rastin tonë, qëllimi i përpilimit të indikatorëve të barazisë është që të matet cilësia e jetës dhe niveli i barazisë tek popullsia e Kosovës. Për të vështuar më mirë gjendjen në këtë fushë, kjo temë është ndarë në dy nën-tema, të cilat janë matur me katër (4) TZHQ të ndryshëm. Derisa varfëria matet me përqindjen e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë, Indeks Gini për pabarazinë e të ardhurave dhe shkallën e papunësisë, nën-tema e dytë vlerësohet me raportin ndërmjet pagës mesatare të grave dhe pagës mesatare të burrave. Ky tregues fatkeqësisht nuk është në dispozicion, prandaj nuk figuron në këtë raport.

Megjithatë, atë që ne mund të shohim nga të dhënat e paraqitura në tabelën më lart, shkalla shtetërore e varfërisë është zvogëluar me rreth 13% që prej vitit 2008. Kjo tregon që jemi duke përjetuar një përparim të butë, por të konsiderueshëm, drejt zbutjes së varfërisë. Me fjalë tjera, derisa përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë ishte 39% më 2008, në vitin 2015 ajo është regjistruar të jetë 25.80%.

Në anën tjetër, Indeksi Gjini, që mat madhësinë e devijimit të shpërndarjes së të ardhurave tek individët apo ekonomitë familjare nga një shpërndarje plotësisht e barabartë, gjithashtu është përmirësuar. Më 2013, që është viti i parë në të cilin mund të gjurmohen të dhënat në dispozicion, Indeksi Gjini për Kosovën qëndronte tek shifra prej 26.71%. Kjo tregon që niveli i pabarazisë është gjithnjë e në ulje.

Përfundimisht, shkalla e papunësisë gjithashtu është ulur për 14.6%, nga 47.5% më 2008 deri tek 32.9% në vitin 2015. Këto shifra janë shqetësuese për një vend që përballet me zhvillim të ngadalshëm ekonomik, sidomos kur krahasohen me shkallën mesatare të papunësisë prej 9.6% në BE. Ky tregues qartësisht paraqet performancë të dobët ekonomike për vendin si dhe nevojë të ngutshme për të marrë masa konkrete drejt sigurimit të një ringjalljeje ekonomike në të gjithë sektorët.

## Health

<b>Treguesit Socialë</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Gjendja e ushqyeshmërisë</b>	<i>Gjendja e ushqyeshmërisë tek fëmijët</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Vdekshmëria</b>	<i>Vdekshmëria e foshnjave (promil)</i>	46	45	44	42	41	39	38	36
	<i>Shkalla e pavdekshmërisë nën 5 vjeç (promil)</i>	44	52	34	62	25	41	24	23
	<i>Jetëgjatësia e pritur në lindje</i>	69.397	69.648	69.9	70.148	70.497	70.797	71.097	71.33
<b>Sanitaria</b>	<i>% e popullsisë me hapësira adekuatë të depozitimit të kanalizimit</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Uji i pijes</b>	<i>Popullsia me qasje në ujë të sigurt të pijes (njësia mil m3)</i>	/	/	56.08	52.68	53.9	53.75	55.84	/
<b>Shëndetësia</b>	<i>% e popullsisë që ka qasje në institucione të kujdesit parësor shëndetësor</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Imunizimi ndaj sëmundjeve infektive të fëmijërisë</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Prevalenca e kontraceptivëve</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Shpenzimet totale në shëndetësi (% e BPV-së)</i>	8.4	7.0	/	1.8	5.9	2.9	7.2	2.3

Spektori i shëndetësisë është një prej sektorëve më të brishtë dhe më një performancë jo të kënaqshme në kuptimin e menaxhimit, tejet i përkeqësuar për shkak të investimeve të kufizuara, si dhe i karakterizuar me reforma të dobëta në përgjigje ndaj nevojave të shoqërisë. Për të kuptuar më mirë kushtet e sektorit shëndetësor në vend, është krijuar një listë prej 8 treguesish. Megjithatë, edhe përtej të dhënave të disponueshme nga të gjitha burimet tona, prapë ka mangësi në qasjen e të dhënave të tilla.

Siç mund të shihet nga të dhënat, vdekshmëria e foshnjave në vend është në nivele të menaxhueshme. Numri i foshnjave që vdesin para moshës 1-vjeçare për 1000 lindje të gjalla është ulur. Statistikat për vitin 2015 tregojnë që shkalla e vdekshmërisë së foshnjave është 36. Duke krahasuar këtë shifër me mesataren botërore prej 32 në vitin 2015, si dhe mesataren e OKB-së prej 49.4, kuptojmë që niveli i shëndetit gjithsesi po përmirësohet me kalimin e kohës. Në anën tjetër, shkalla e vdekshmërisë deri në moshën 5 vjeçare, matës që i referohet probabilitetit të vdekjes para asaj moshe, si dhe shprehet si numër i vdekjeve për 1000 lindje të gjalla.

Siç mund të shihet nga shifrat në tabelë, periudha e studimit karakterizohet me luhatje të ndryshme, por trendet kanë qëndruar stabile. Më 2015, shkalla e vdekshmërisë nën moshën 5-vjeçare për 1000 lindje të gjalla ishte 23, që është mbi 3 herë më i ultë se mesatarja në botë (73.7) e raportuar sipas OKB-së.

Në kuptimin e jetëgjatësisë së pritur në lindje, edhe pse shohim një rritje për afërsisht 2 vjet, nga mesatarja prej 69.3 më 2008 në 71.33 më 2015, Kosova ende mbetet prapa në rajon, me mesatarisht 5 vite më pak sesa jetëgjatësia e pritur e qytetarëve të vendeve fqinje.

Përfundimisht, në vitin 2014, vetëm 55.84% e popullsisë kishin qasje në ujë të sigurt për pije. Sipas të gjitha gjasave, infrastruktura e dobët e rrjetit furnizues është duke iu pamundësuar një pjese të mirëfilltë të popullsisë për të pas qasje në ujë të pishëm, pasi që në vitin 2010 kjo

## Arsimi

<b>Treguesit sociale</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Niveli arsimor</b>	<i>Numri i fëmijëve në arsimin parashkollor</i>	23,826	24,033	24,655	24,945	26,431	28,483	26,245	26,154
	<i>Fillor dhe i mesëm i ulët</i>	319,154	306,299	302,253	294,419	286,677	282,918	275,887	29,516
	<i>Arsimi i mesëm i lartë</i>	96,765	104,806	108,503	109,513	107,303	103,038	86,219	87,847
	<i>Vijimi i arsimit universitar</i>	21,564	37,839	45,725	49,844	65,315	52,159	69,220	120,429
	<i>Buxheti për arsim (% e BPV-së)</i>	8.20%	5.70%	4.06%	4.03%	4.60%	4.38%	4.4%	4,5%
<b>Shkrim-leximi</b>	<i>Shkalla e alfabetizimit tek të rriturit</i>	/	92.7%	/	96%	94%	95.8%	/	/

Arsimi, në anën tjetër, edhe pse tejet i rëndësishëm për matjen e prosperitetit të një shoqërie, është një sektor tjetër në Kosovë që përballet me shumë sfida e vështirësi, si dhe që është «privuar» nga investimet madhore që nevojiten për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së tij.

Përditë e më shumë po theksohet që numri i fëmijëve që vijojnë arsimin parashkollor është masë tejet e rëndësishme në përmirësimin e zhvillimit fizik, social, intelektual e emocional të fëmijëve. Në këtë drejtim, në Kosovë, shohim një trend pozitiv. Derisa numri më 2008 arrinte në 23,826 fëmijë, shifra është përmirësuar për pothuajse 10%, duke arritur në shifrën prej 26,154 fëmijë që ndjekin arsimin parashkollor më 2015.

Sa i përket statistikave për arsimin universitar, numri i studentëve të regjistruar është rritur gjashtëfish në krahasim me vitin 2008. Derisa në pamje të parë kjo do të duhej vështruar si trend tejet pozitiv, rrethanat aktuale zhvillimore nuk na japin luksin për të pasur një gjykim të tillë. Mes tjerash, rritja e numrit të studentëve është rezultat i masave të përkohshme që përdoren nga Qeveria për të luftuar në mënyrë fiktive nivelet e larta të papunësisë, prandaj këto shifra nuk është se tregojnë ndonjë progres drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit apo të aftësive e shkathtësive të përfituara nga ana e të diplomuarve.

Përfundimisht, buxheti i arsimit si përqindje e BPV-së është zvogëluar për gati 50% në krahasim me vitin 2008. Ky fakt është në të vërtetë tejet kundërthënës, pasi që numri i studentëve në të gjitha kategoritë është rritur në masë të madhe. Këto të dhëna na bëjnë të besojmë që buxheti për nxënës/studentë është në ulje të vazhdueshme, duke prekur kështu drejtpërdrejt cilësinë e arsimit që i ofrohet atyre. Ritheksojmë që performanca e dobët e sektorit arsimor ka efekte negative afatgjata tek të gjitha fushat tjera të shoqërisë.

## Banimi

<b>Treguesit Socialë</b>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Kushtet e jetesës</b>	<i>Sipërfaqe banimi për Person</i>	/	/	/	/	/	/	/	/

Në lidhje me banimin, jemi interesuar të vlerësojmë kushtet e jetesës në vend, të matura me treguesin e hapësirës së banimit për person, siç ofrohet nga Metodologjia që përdoret nga Kombet e Bashkuara.

Fatkeqësisht, këto të dhëna aktualisht nuk janë të disponueshme për vendin tonë.

## Siguria

<b>Treguesit socialë</b>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Krimi</b>	<i>Numri i krimeve të regjistruara (dënuar)</i>	12,472	12,652	9,503	17,811	20,406	15,832	18,330	/

Treguesi i zgjedhur për matjen e nivelit të sigurisë në vend është numri i krimeve të regjistruara që gjithashtu kanë marrë dënimin. Në bazë të të dhënave të mbledhura, shohim që numri i krimeve të dënuara ka parë luhatje të ndryshme gjatë periudhës së studimit. Derisa në krahasim me vitin bazë 2008, numri i krimeve të dënuara është rritur për gati 6000 raste, mund të zbulojmë edhe një përmirësim pozitiv dhe tejet të rëndësishëm në këtë drejtim, nga viti 2012 deri më 2013. Në këtë periudhë, numri i krimeve të dënuara është zvogëluar për gati 5.000 sosh.

## Popullsia

<b>Treguesit socialë</b>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Ndryshimi i popullsisë</b>	<i>Rritja e popullsisë (% vjetore)</i>	0.8032%	0.8031%	0.8032%	0.8566%	0.7921%	0.7129%	0.2763%	/
	<i>Popullsia në vendbanimet formale dhe joformale urbane</i>	/	/	/	/	/	/	/	/

Platforma e TZHQ-ve e Kombeve të Bashkuara, si pjesë e treguesve të saj në fushën e qëndrueshmërisë sociale, gjithashtu përfshinte matjen në lidhje me trendet që kanë të bëjnë me popullsinë e vendit. Me këtë rast kemi identifikuar dy tregues kryesorë për të vështruar zhvillimet në këtë fushë. Megjithatë, në bazë të burimeve të disponueshme, kemi arritur të mbledhim të dhëna vetëm për përqindjen vjetore të rritjes së popullsisë. Siç mund të shihet nga tabela, Kosova po përjeton një zvogëlim serioz në kuptimin e rritjes së popullsisë. Derisa rritja vjetore e popullsisë e shprehur në përqindje ishte 0.803% më 2008, kjo tashmë është ulur në 0.276% në vitin 2014. Mund të identifikohen shumë faktorë që kontribuojnë në këtë drejtim, duke filluar nga rritja e shpenzimeve jetësore e realizuar në fushën e planifikimit familjar.

## Migrimi

<i>Treguesit socialë</i>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Rrjedhat e migrimit</b>	<i>Numri i emigrantëve</i>	/	14,925	14,500	10,695	10,335	20,246	45,333	74,434
	<i>Numri i imigrantëve</i>	/	/	/	/	/	3,864	5,720	18,862

Një prej plagëve më të mëdha të shoqërisë kosovare është migrimi. Për dekada, migrimi e ka formësuar shoqërinë kosovare. Ajo çka vlenë të ceket është që metodologjia e përdorur për raportimin e trendeve migruese në vend nuk është konsistente ndër vite. Siç raportohet në studimin tonë «Pasqyrë e migrimit të kosovarëve drejt BE-së: Migrimi si fenomen shumëfaqësh», nga viti 2008 e deri më 2014, rreth 120,000 persona kanë braktisur Kosovën, nga të cilët rreth 90,000 persona kanë lëvizur drejt shteteve anëtare të BE-së, derisa të tjerët kanë migruar drejt SHBA-ve apo Kanadasë. Ky numër nuk është tërësisht i saktë, pasi që shumë kosovarë janë paraqitur në zyrat e migrimit me pasaporta serbe. Ky fakt ka shkaktuar mbledhje jokonsistente të të dhënave në lidhje me numrin e saktë të migruesve kosovarë.

## Benefitet Sociale

<i>Treguesit socialë</i>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Kontributet pensionale</b>	<i>Pensionet bazë</i>	138,847	112,553	109,858	107,145	113,043	117,049	125,883	132,000
	<i>Kontribute pensionale</i>	/	/	30,641	31,415	34,722	36,051	38,651	40,365
	<i>Pensione invalide</i>	19,746	18,533	19,392	18,594	17,531	12,240	18,318	19,056
	<i>Pensione për dëshmorë dhe invalidë</i>	11,509	12,285	12,994	13,109	13,232	13,196	13,097	12,652

Për shkak të niveleve të larta të papunësisë, kemi vendosur të zgjerojmë listën e treguesve të qëndrueshmërisë sociale duke përfshirë edhe benefitet sociale – një mënyrë për të kontrolluar politikat e qeverisë për t'i ofruar ndihmë qytetarëve të saj në drejtim të përballimit të sfidave të së jetuarit.

Është me interes të theksohet që trendet në secilën kategori kanë lëvizur në drejtime të ndryshme nga viti në vit.

Numri i përfituesve të pensionit bazë është ulur nga 138.847 në vitin 2008 në 132.000 më 2015. Në anën tjetër, numri i kontribut-paguesve është rritur nga 30.641 më 2008 në 40.364 më 2015. Kjo nënvizon faktin që numri i të papunëve është zvogëluar, pasi që numri i kontribuesve në skemën pensionale është rritur – duke shënuar kështu një trend pozitiv në këtë fushë.

Në anën tjetër, numri i përfituesve të pensioneve invalide është ulur nga 19,746 më 2008 në 19,056 më 2015.

Përfundimisht, për shkak të luftës më 1999, Qeveria e Kosovës ka ndarë fonde të posaçme për dëshmorë dhe invalidë. Numri i përfituesve në këtë kategori është rritur nga 11,509 më 2008 deri në 12,652 më 2015. Arsyet për këtë mund të jenë të shumta, por, perceptimi i përgjithshëm është që ka pasur keqmenaxhim dhe abuzim me këto fonde, gjë që paraqet problem të vazhdueshëm për qeverinë.



## **TZHQ-të – dimensionimi mjedisor**

Zhvillimi i qëndrueshëm është i lidhur ngushtë me ruajtjen e mjedisit dhe në diskursin publik ndërlidhet me veprimet e shumë aktorëve drejt mbrojtjes së mjedisit që na rrethon.

Dimensioni mjedisor i zhvillimit të qëndrueshëm ka të bëjë me idenë që të gjitha kërkesat që ne kemi ndaj mjedisit të mund të përmbushen pa iu flijuar mundësitë e njëjta personave të tjerë dhe gjeneratave të ardhme.

Duke u bazuar në zhvillimet e fundit, kuptojmë që kemi arritur një nivel të degradimit mjedisor që po kërcënon mirëqenien e tokës. Shpyllëzimi në rritje, ndotja gjithnjë e më e madhe, rritja e temperaturave globale, ndryshimet klimatike, etj., janë vetëm disa prej treguesve kryesorë që na bëjnë të besojmë se sjellja jonë ndaj tokës është armiqësore.

Për të siguruar qëndrueshmërinë mjedisore, ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve në këtë fushë. Për hir të matjes së trendeve mjedisore në Kosovë, ne kemi zgjedhur tregues të ndryshëm, duke përfshirë: atmosferën, ujin e freskët dhe larinë biologjike.

Për të pasur çfarëdo mundësie të ruajtjes së qëndrueshmërisë mjedisore, të gjitha palët, duke përfshirë politikë-bërësit, bizneset, qytetarët, etj., duhet të lëvizin larg prej ndjenjës së eksploatimit të plotë të mjedisit për dobi vetanake e afatshkurtëra, drejt sensit të ndërvarësisë së ndërsjellë rajonale e globale.

Ka masa të ndryshme që mund të merren nga të gjithë ne për të ecur drejt një niveli më të lartë të qëndrueshmërisë mjedisore. Këto masa janë: zvogëlimi i nivelit të CO<sub>2</sub>, ndalja e shkatërrimit të pyjeve; kombinimi i tkurrjes (së shfrytëzimit të karbonit për pjesët e prekura të botës) si dhe konvergencës për të përputhur gjurmën e karbonit (carbon footprints) në botë, etj.

Për të kuptuar nivelin e qëndrueshmërisë mjedisore në vend, në vijim është paraqitur lista e TZHQ-ve të zgjedhur:

## Atmosfera

<b>Treguesit mjedisorë</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Cilësia e ajrit</b>	<i>Emisionet e gazrave serrë (GG CO<sub>2</sub> përafërt)</i>	9,500	10,500	9,780	9,700	9,526.7	9,568.4	/	/
	<i>Emisionet nga TC Kosova A (mg/NM<sup>3</sup> Co<sub>2</sub>)</i>	/	/	/	/	261.83	262.62	262.91	259.67
	<i>Emisionet nga TC Kosova B (mg/NM<sup>3</sup> Co<sub>2</sub>)</i>	/	/	/	/	250.44	238.2	216.04	220.7
	<i>Emisionet industriale</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Emisionet nga transporti</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Emisionet e SO<sub>2</sub> (për TC Kosova A + B / mg/NM<sup>3</sup>)</i>	/	/	/	/	1145.17	1468	929	616
	<i>Emisionet e NO<sub>x</sub> (për Tc Kosova A + B/ mg/NM<sup>3</sup>)</i>	/	/	/	/	1481.3	1536	1529	1546
<b>Mbeturi- nat</b>	<i>Mbeturinat komunale (në 1000 tonë)</i>	351	405	515	582	607	575	247	/
	<i>Mbeturina komunale për person (KG/banor)</i>	167	193	297	335	334	317	140	/
	<i>Mbeturina Industriale (prodhuar në Ton)</i>	/	/	566,566	/	412,704	302,205	302,205	/

Kosova kritikohet nga shumë raporte ndërkombëtare për nivelin e performancës në fushën e ndotjes. Për të matur performancën e vendit në këtë drejtim, kemi zgjedhur 10 tregues që janë grupuar në dy nën-tema, cilësia e ajrit dhe mbeturinat.

Sa i përket cilësisë së ajrit, emitimet e gazrave me efekt serrë në Kosovë janë rritur në krahasim me vitin bazë, pasi që në vitin 2008, emitimet GG CO<sub>2</sub> shkonin deri në nivelin prej 9.500, derisa në vitin 2013, ato janë vlerësuar në nivel të përafërt me 9.568,7. Kulminacioni i emitimeve GG CO<sub>2</sub> u arrit në vitin 2009, me një nivel të vlerësuar prej 10,500 GG CO<sub>2</sub>.

Ndotësit më të mëdhenj në vend janë dy termocentralet në funksion, përkatësisht Kosova A dhe Kosova B. Niveli i emitimeve të TC Kosova A më 2015 ishte 259.67 mg/NM<sup>3</sup> CO<sub>2</sub>, derisa kontributi i TC Kosova B në të njëjtin vit ishte 220.7 mg/NM<sup>3</sup> CO<sub>2</sub>. Në anën tjetër, emisionet e SO<sub>2</sub> për TC Kosova A dhe B, shprehur në mg/NM<sup>3</sup>, kanë qenë 616, dhe 1,546 respektivisht.

Sa i përket mbeturinave, niveli i mbeturinave komunale në 1000 tonë është zvogëluar nga 351 më 2008 deri në 140 më 2014. Ngjashëm, niveli i mbeturinave për person është zvogëluar, ndryshe shprehur në KG/banor. Numrat për vitin 2008 tregojnë nivelin prej 167 kg/banor, derisa më 2014, të dhënat përmendin nivelin prej 140kg/banor. Përmirësimi i konsiderueshëm në këtë fushë, krahasuar me vitin 2013, është lehtësisht i vërejtshëm.

Përfundimisht, për sa i përket mbeturinave industriale të prodhuara në ton, kemi trend të zvogëlimit, nga 566,566 më 2010 në 302,205 në 2014, një konfirmim i rradhës për sa i përket degradimit të sektorit industrial në vend.

## Uji i Freskët

Treguesit mjedisore		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Cilësia e ujit	BOD në trupa ujorë	/	/	/	/	/	/	/	/
	Koncentrimi i koliformit fekal në ujë të freskët	/	/	/	/	/	/	/	/
Sasia e ujit	Tërheqja vjetore e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore si përqindje e totalit të ujit në dispozicion	/	/	/	/	/	/	/	/

Edhe pse në bazë të listës referente të TZHQ-ve të siguruar nga OKB-ja, uji i freskët matet sipas cilësisë dhe sasisë së ujit përmes identifikimit të tre treguesve të ndryshëm, fatkeqësisht nuk kemi arritur të gjejmë asnjë nga këto të dhëna tek burimet statistikore referuese.

Kështu, zotimi për mbledhjen e këtyre të dhënave nga institucionet relevante të Kosovës, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës është i domosdoshëm.

## Toka

Treguesit mjedisore		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Bujqësia	Sipërfaqja e tokave të punueshme dhe me të mbjella të përhershme (në ha)	261,165	267,147	/	/	277,364	296,830	180,381	/
	Përdorimi i plehrave (hisja në 1000 Euro: 17.706)	182.3	174.5	100	126	142.4	146.1	139.19	/
	Përdorimi i pesticideve bujqësore (hisja në 1000 Euro: 2.335)	99.8	99.4	100	98.5	99.6	129.7	159.35	/
Pyjet	Sipërfaqe puçore si përqindje e sipërfaqes tokësore (vetëm në ha; rreth 44.7%)	512	830	239	302	545	538	/	/
	Intensiteti i prerjes së pyjeve	/	/	/	/	/	/	/	/
Shkretërimi	Toka e prekur nga shkretërimi	/	/	/	/	/	/	/	/
Urbanizimi	Sipërfaqja e vendbanimeve formale dhe joformale urbane	/	/	/	/	/	/	/	/

Si pjesë e treguesve të qëndrueshmërisë mjedisore, kemi hulumtuar edhe performancën e vendit në fushën e bujqësisë, pylltarisë, shkretërimit (shpyllëzimit) dhe urbanizimit. Janë zgjedhur gjithsej 7 tregues për të matur zhvillimet në këto fusha.

Siç mund të shohim nga tabela e sipërme, sipërfaqja totale e tokave të punueshme dhe me të mbjella të përhershme në Kosovë ishte 180, 381 ha më 2013. Njëkohësisht, mund të shohim që derisa ka një trend në ulje në përdorimin e plehrave, në anën tjetër përdorimi i pesticideve bujqësore në bujqësi është gjithnjë në rritje.

Sa i përket pyjeve, sipërfaqja pyjore si përqindje e tokës më 2013 ishte 538 ha. Në anën tjetër, të dhënat për intensitetin e prerjes së pyjeve nuk janë të disponueshme.

Përfundimisht, nuk kemi arritur të nxjerrim ndonjë informatë në lidhje me tokën e prekur nga shkretërimi, e as të dhëna në lidhje me vendbanimet formale dhe joformale urbane, pasi statistikat për këto çështje nuk janë të disponueshme.

## Biodiversiteti

<i>Treguesit mjedisorë</i>		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Eko-sistemi</b>	<i>Sipërfaqja e ekosistemeve kyçe të zgjedhura</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Sipërfaqja e mbrojtur si % e sipërfaqes totale</i>	10.90%	10.90%	10.90%	10.90%	10.90%	10.90%	10.90%	10.90%
<b>Speciet</b>	<i>Begatia e specieve kyçe të zgjedhura</i>	/	/	/	/	/	/	/	/

Përfundimisht, sa i përket biodiversitetit, kemi zgjedhur tre tregues kryesorë për të matur nivelin e progresit dhe fazën e zhvillimit në këtë fushë. Megjithatë, pasi kryem hulumtimin, kemi arritur të shohim që ka mungesë të të dhënave dhe informatave në dispozicion në këtë drejtim.

Mirëpo, siç mund të shihet në tabelë, kemi arritur të kuptojmë % e zonës së mbrojtur në krahasim me sipërfaqen totale. Kjo statistikë ka mbetur e njëjtë përgjatë gjithë periudhës së studimit. Kështu, në Kosovë, zona e mbrojtur si përqindje e sipërfaqes totale vlerësohet të jetë 10.90%.

## **TZHQ-të – dimensioni ekonomik**

Sigurisht që dimensionin më i diskutuar si dhe më strategjik i zhvillimit të qëndrueshëm konsiderohet të jetë qëndrueshmëria ekonomike.

Shpesh thuhet që zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i qëndrueshëm nuk mund të shkojnë krah për krah, pasi duhet sakrifikuar njërin për të pasur sukses me tjetrin. Megjithatë, pothuajse të gjitha investimet dhe hulumtimet tashmë po shkojnë mu në drejtimin e të siguruarit që këto dy komponente të shkojnë krah për krah, për të ruajtur një të ardhme premtuese edhe për gjeneratat që do të vijnë.

Në platformën e TZHQ-ve të dizajnuar nga ne, kemi zgjedhur një numër prej 22 nën-temash për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës. Këto nën-tema janë matur me anë të disa treguesve, që na kanë ndihmuar të kuptojmë strukturën ekonomike të Kosovës, trendet e konsumit dhe prodhimit të saj, nivelet e punësimit dhe papunësisë, etj.

Të gjithë këta tregues të kombinuar na shërbejnë për të kuptuar nivelin e përparimit që vendi ka shënuar në fushën e zhvillimit ekonomik që nga viti 2008.

Kosova aktualisht është në një fazë tejet kritike të zhvillimit të saj, duke kërkuar të gjejë nivelin adekuat për të baraspeshuar përpjekjet e saj për zhvillim ekonomik kundrejt presioneve sociale për të siguruar që kjo të bëhet në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Derisa kjo detyrë nuk duket e lehtë e arritshme, fillimisht vendosëm të bëjmë një kontroll të gjendjes së treguesve kryesorë, për të ofruar pastaj rekomandime më të informuara përmes hulumtimeve dhe punës tone në fushën e politikave.

Për të kuptuar nivelin e qëndrueshmërisë ekonomike në vend, më poshtë është paraqitur lista e TZHQ-ve të përzgjedhura:

## Struktura Ekonomike

<b>Treguesit ekonomikë</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Performanca ekonomike</b>	<i>BPV (€ milionë)</i>	3,882.8	4,069.6	4,402	4,814.5	5,058.8	5,326.6	5,567.5	5,771.5
	<i>BPV për kokë banori (\$ amerikanë aktual)</i>	3254.8606	3209.6941	3283.2119	3736.8409	3600.8870	3890.3006	4051.6483	/
	<i>Hisja e investimeve në BPV</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Shkalla e inflacionit në IÇK (% vjetore)</i>	9.35%	-2.41%	3.48%	7.33%	2.47%	1.76%	0.43%	0.50%
	<i>PPP (\$ milionë)</i>	12,664	13,219	13,823	14,726	15,419	16,201	16,920	17,930
<b>Tregtia</b>	<i>Bilanci tregtar në mallra e shërbime (€ milionë)</i>	-1729.8	-1770.2	-1861.8	-2173.2	-2231.5	-2155.2	-2213.8	-2309.4
	<i>Eksporte (€ milionë)</i>	198.5	165.3	295.9	319.2	276.1	293.8	324.5	325.3
	<i>Importe (€ milionë)</i>	1,928.2	1,935.5	2,157.7	2,492.4	2,507.6	2,449.1	2,538.3	2,634.7
	<i>Raporti eksport/import</i>	10.3%	8.5%	13.7%	12.8%	11.0%	12.0%	12.8%	12.3%
	<i>Pasqyra rrjedhëse (€ milionë)</i>	-925	-522	-684	-917	-488	-450	-586	-505
	<i>Pasqyra e kapitalit (€ milionë)</i>	10.45	100.28	21.3	42.04	12.96	34.7	/	/
	<i>Pasqyra financiare (€ milionë)</i>	288.5	109.05	275.86	376.82	130.31	123.5	/	/
<b>Gjendja financiare</b>	<i>Raport borxh/BPB</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>NET ODA dhënë apo marrë si përqindje e GNI-së</i>	/	13.62%	8.91%	8.51%	8.46%	7.85%	7.68%	/
<b>Investime</b>	<i>IHD (BoP, rrjedhëse €)</i>	500,230,652	393,488,927	454,181,772	539,305,295	72,977,856	319,350,167	164,301,885	/
	<i>Neto IHD hyrëse % e BPV-së</i>	9.43%	7.21%	8.34%	8.16%	4.51%	4.85%	2.7%	/
	<i>Lokale</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Remitenca</b>	<i>Remitenca (% e BPV-së)</i>	18.32%	18.66%	17.09%	16.75%	16.29%	15.86%	16.14%	/

Nuk është ndonjë befasi që të dhënat në dispozicion për treguesit e qëndrueshmërisë ekonomike janë larg më të shumta në krahasim me dy fushat tjera, respektivisht qëndrueshmëria sociale dhe ekonomike. Aspekti ekonomik është tejet i rëndësishëm për politika ndërlydhe në mes të sektorëve të ndryshëm, e kështu, zhvillimet në këtë fushë janë me rëndësi të madhe. Për të vlerësuar strukturën ekonomike të vendit, kemi klasifikuar një tërësi prej 18 treguesish.

Siç mund të shihet, në krahasim me vitin bazë 2008, BPV e vendit është rritur nga 3,882.8 € milionë në 5771.5 milionë euro më 2015. Kështu është rritur edhe BPV për kokë banori në terma pozitive, por edhe Pariteti i Fuqisë Blerëse (PPP). Megjithatë, edhe pse rritja reale e BPV-së është vlerësuar të jetë 3.5% për vitin 2015, kjo është ende e pamjaftueshme për nivelin e zhvillimit ekonomik në vend. Në këtë stad të zhvillimit ekonomik, është pothuajse gjerësisht e pranueshme që për të luftuar papunësinë dhe për të siguruar performancë stabile ekonomike, vendi duhet të gëzojë rritje të BPV-së prej rreth përafërsisht 7%. Në anën tjetër, shkalla e inflacionit të Indeksit të Çmimit të Konsumit, shprehur në përqindje, i është nënshtruar një përmirësimi të konsiderueshëm, duke u zvogëluar nga 9.35% më 2008 në 0.50% më 2015. Mirëpo, të dhënat në lidhje me hisen e investimeve brenda BPV-së nuk janë të disponueshme.

Në anën tjetër, për të matur performancën e vendit në tregti, kemi zgjedhur 7 tregues. Ajo që vërehet është trendi i bilancit të vazhdueshëm negativ tregtar. Përkundër faktit që bilanci tregtar i Kosovës është dominuar nga eksportet, është shumë e dukshme që bilanci negativ tregtar është në rritje të vazhdueshme. Pra, edhe pse eksportet janë rritur me gati dyfish në krahasim me vitin bazë 2008, përpjesëtimi i tyre me importe është gati i pakrahasueshëm. Importet janë rritur nga 1926.2 milionë euro më 2008 në 2634.7 milionë më 2015.

E ngjashme është gjendja në kuptimin e shumës rrjedhëse dhe asaj kapitale. Pasqyra rrjedhëse dhe ajo kapitale janë dy komponentët kryesorë të bilancit të pagesave të një shteti. Me pasqyrë rrjedhëse prej -505 € milionë më 2015, mund të kuptojmë që Kosova është huamarrëse e madhe neto. Në anën tjetër, shuma e investimeve të huaja direkte (IHD), portofoli dhe investimet tjera, plus ndryshimet në llogaritë rezervë, të përmbledhura në pasqyrën kapitale, tregojnë që më 2013 është arritur niveli prej 34.7 milionë Euro. Në anën tjetër, pasqyra financiare për vitin 2013 ka arritur nivelin prej 123.5 milionë Euro.

Më tutje, më 2014, ndihma zyrtare zhvillimore neto (ODA), që përbëhet nga disbursimi i kredive në bazë të termave koncesionare dhe granteve nga agjencitë zyrtare të anëtarëve të Komitetit të Ndhmës në Zhvillim (DAC), nga institucionet shumëpalëshe, si dhe nga vendet që nuk bëjnë pjesë në DAC, ka arritur nivelin prej 7.68% të GNI-së.

Përfundimisht, klima e investimeve është ndikuar shumë në kuptimin negativ. Më 2014, rrjedhat hyrëse të IHD-ve neto në përqindje të BPV-së kanë qenë 2.7%, që është zvogëlim nga shkalla prej 9.43% më 2008. Derisa remitencat ende përbëjnë një pjesë të madhe të BPV-së, e ndërsa kontributi i tyre është zvogëluar, pasi që më 2014 remitencat përbënin 16.14% të BPV-së.

## Trendet e Konsumit dhe Prodhimit

<b>Economic Indicators</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Konsumi për Sektorë</b>	<i>Industria</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Ekonomitë familjare</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Shërbime</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Bujqësia</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Transportimi (in %)</i>	5%	5%	6%	6%	4%	4%	5%	4%
<b>Konsumi i përgjithshëm</b>	<i>Ekonomitë familjare (Urbane)</i>	6,894	7,429	7,588	7,492	8,015	8,050	8,041	7,894
	<i>Ekonomitë familjare (Rurale)</i>	6,536	6,426	6,763	6,671	7,370	7,279	7,281	7,215
	<i>Ekonomitë familjare (gjithsej) (€ për ekonomi familjare)</i>	6,707	6,847	7,110	7,010	7,657	7,625	7,611	7,503
<b>Konsumi material</b>	<i>Intensiteti i përdorimit të materialeve</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Prodhimi dhe Menaxhimi i mbeturinave</b>	<i>Gjenerimi i mbeturinave inerte industriale dhe komunale (në Ton)</i>	/	/	/	1,162,154	1,012,704	877,205	/	/
	<i>Gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme (në Ton)</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Gjenerimi i mbeturinave radioaktive</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
	<i>Riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave</i>	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Transportimi</b>	<i>Gjithsej distanca rrugore e kaluar (në km)</i>	1.925,1	1.925,1	1.925,1	1.963,1	1.985,5	2.005,5	2.005,5	2012,0

Siç mund të shihet lehtësisht nga tabela, shumë nga treguesit e klasifikuar në këtë kategori nuk monitorohen në Kosovë. Kështu, nuk ka të dhëna të disponueshme për ta. Megjithatë, ajo që kemi arritur të nxjerrim në lidhje me trendët e konsumit dhe prodhimit në vend është konsumi i përgjithshëm i nivelit të ekonomive familjare, në zonat urbane dhe ato rurale. Ajo që mund të shohim, në të dyja rastet, është që konsumi i përgjithshëm është rritur. Derisa në zonat urbane ka lëvizuar nga mesatarja prej 6894 € për ekonomi familjare më 2008 drejt 7894 € për ekonomi familjare më 2015. E njëjta vlen për zonën urbane, ku niveli i konsumit në Euro për ekonomi familjare është rritur nga diku rreth 6536 më 2008 në 7215 më 2015.

Të dhënat tjera nuk janë konsistente për vitet e studimit. Megjithatë, është interesante t'i referohemi njërit prej treguesve në këtë kategori, respektivisht distancës totale rrugore të kaluar në km, që është rritur nga 1.925,1 km më 2008 në 2.012,0 km më 2015.



## Punësimi

<b>Treguesit ekonomikë</b>		<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
<b>Statistikat e punësimit</b>	<i>Shkalla e punësimit</i>	24.3%	26.4%	/	/	25.6%	28.4%	26.9%	25,2%
	<i>Shkalla e papunësisë</i>	47.5%	45.4%	38.2%	34.5%	30.9%	30%	35.3%	32,9%
	<i>Papunësia e të rinjve</i>	73%	73%	/	/	55.3%	55.9%	61%	57,7%
	<i>Raporti i punësimit të grave kundrejt burrave</i>	39.66	42.89	/	/	32.25	35.04	/	/
<b>Punësimi i gjinive</b>	<i>Burra</i>	38%	40.2%	/	/	39.9%	44%	41.3%	38,7%
	<i>Gra</i>	10.6%	12.6%	/	/	10.7%	12.9%	12.5%	11,5%
<b>Punësimi për sektorë</b>	<i>Bujqësi</i>	8%	6.2%	/	/	4.6%	5.9%	2.6%	2,3%
	<i>Miniera</i>	1.5%	1.1%	/	/	1.2%	1.3%	1.1%	0,8%
	<i>Industri (prodhim)</i>	8.7%	9.9%	/	/	14.3%	12.6%	13.8%	14,6%
	<i>Energji</i>	5.2%	4.5%	/	/	2.3%	1.7%	1.7%	1,8%
	<i>Furnizimi i ujit, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave</i>	/	/	/	/	/	/	1,0%	1,5%
	<i>Ndërtimtari</i>	8.6%	7.9%	/	/	9.5%	11.4%	10.9%	9,5%
	<i>Tregti</i>	17.1%	17.4%	/	/	13.4%	12.8%	14.4%	14,3%
	<i>Akomodim dhe hoteleri</i>	4.5%	4.6%	/	/	4.8%	5.3%	6%	6,6%
	<i>Informim e komunikim</i>	/	/	/	/	/	/	2,9%	3,2%
	<i>Transport</i>	5.6%	5.8%	/	/	3.5%	3.2%	3.4%	2,8%
	<i>Financa</i>	1.8%	2.2%	/	/	2.2%	2.2%	1.8%	2,0%
	<i>Aktivite profesionale, shkencore e teknike</i>	/	/	/	/	/	/	2,0%	1,8%
	<i>Aktivite të shërbimeve administrative dhe përkrahëse</i>	/	/	/	/	/	/	3,4%	3,6
	<i>Biznese</i>	2.6%	2.9%	/	/	/	/	/	/
	<i>Administrata publike</i>	9.7%	9.8%	/	/	9.7%	8.7%	9.8%	7,4%
	<i>Arsim</i>	13.6%	13.4%	/	/	12%	11.1%	11.9%	12,2%
	<i>Shëndetësi</i>	6.5%	7%	/	/	7.5%	8.1%	7.2%	6,2%
	<i>*Aktivite të ekonomive familjare si punëdhënës</i>	/	/	/	/	/	/	2,9%	2,4%
	<i>Arte, argëtim dhe rekreacion</i>	/	/	/	/	/	/	1,5%	1,5%
	<i>Të tjera</i>	6.7%	7.5%	/	/	5.9%	5.5%	4.9%	5,4%

Sigurisht që punësimi është referencë e mirë për të parë dinamikën e tregut të punës dhe performancën e ekonomisë në përgjithësi. Fatkeqësisht, Kosova ka një prej normave më të larta të papunësisë, që arrin deri në 32.9% më 2015, derisa shkalla e punësimit më 2014 ka qenë 25.2%. Papunësia tek të rinjtë po ngec prapa, sidomos kur e kemi parasysh që po flasim për vendin e “Evropianëve të Rinj.” Më 2015, papunësia në këtë grup ishte 57.7%. Ndërkohë, raporti i punësimit të grave kundrejt burrave më 2013 qëndronte në 35.04%, gjë që tregon që pjesëmarrja e gruas në tregun e punës është ende e ulët, duke qëndruar në 11.5% më 2015 – ndryshe një zvogëlim prej 1% nga viti 2014.

Në anën tjetër, është interesante të shihet se cilët sektorë krijojnë shkallën më të lartë të punësimit. Ngjashëm me vitin 2008, është sektori i tregtisë ai që kontribuon më së shumti në punësim, derisa pjesa e tij më 2008, që ishte 17.1%, është zvogëluar në 14.3% më 2015. Mirëpo, sektori i tregtisë shihet qartë që ende dominon në këtë kuptim. Lëvizjet në sektorë të tjerë kanë pasur luhatje nga viti në vit. Gjithsesi, është me interes të theksohen trendet pozitive në sektorin industrial (prodhues), pjesa e të cilit në punësimin e përgjithshëm në vitin 2015 renditej e dyta, me 14.6%.

## Ndërmarrësia

Treguesit ekonomikë		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i ndër-marrjeve për sektor	Miniera dhe gurthyes	206	199	204	201	229	149	149	/
	Prodhimtari	4,065	4,103	4,112	4,246	4,598	3,736	4,052	/
	Furnizim i energjisë elektrike, gazit, avullit dhe kondicionimit të ajrit	46	52	63	59	68	28	28	/
	Furnizim i ujit, sanitari, aktivitete të mbeturinave dhe rivitalizimit të tokës	1,414	1,449	1,874	1,546	1,685	144	139	/
	Ndërtimtari	2,362	2,459	2,564	2,702	3,038	2,094	2,150	/
	Tregti me shumicë e pakicë, riparim veturash dhe motoçikletash	20,815	21,125	19,775	19,791	20,509	16,091	16,142	/
	Transportim e depozitim	1,213	1,228	1,135	1,168	1,160	1,166	1,185	/
	Aktivitete akomodimi dhe shërbimi ushqimor	3,498	3,559	3,364	3,459	3,715	3,126	3,360	/
	Informim e telekomunikim	3,615	3,706	3,731	3,696	3,563	626	693	/
	Aktivitete të tjera	3,891	4,209	4,241	4,558	3,912	1,897	4,023	/
Numri i të punësuarve për aktivitet të sektorit ekonomik	Miniera dhe gurthyes	2,943	3,796	3,694	4,297	3,027	2,636	2,920	/
	Prodhimtari	16,183	16,748	17,827	19,204	25,213	22,932	22,257	/
	Furnizim i energjisë elektrike, gazit, avullit dhe kondicionimit të ajrit	7,444	8,031	8,251	8,946	9,104	9,025	8,470	/
	Furnizim i ujit, sanitari, aktivitete të mbeturinave dhe rivitalizimit të tokës	4,158	5,062	5,381	5,345	5,645	4,047	4,530	/
	Ndërtimtari	7,248	10,300	13,676	14,993	17,779	16,297	13,192	/
	Tregti me shumicë e pakicë, riparim veturash dhe motoçikletash	27,207	31,461	35,358	39,459	47,302	57,379	54,295	/
	Transportim e depozitim	5,672	6,765	7,186	7,677	9,203	7,043	6,316	/
	Aktivitete akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6,478	6,992	7,432	6,356	7,389	11,174	10,488	/
	Informim e telekomunikim	4,286	5,199	5,527	5,722	6,806	7,056	7,314	/
	Aktivitete të tjera	7,223	10,369	10,595	11,220	13,965	12,297	15,954	/
Paga mesatare për aktivitet të sektorit ekonomik (bruto €)	Miniera dhe gurthyes	348	357	382	383	561	461	470	/
	Prodhimtari	228	228	227	248	275	332	326	/
	Furnizim i energjisë elektrike, gazit, avullit dhe kondicionimit të ajrit	486	469	555	557	564	608	610	/
	Furnizim i ujit, sanitari, aktivitete të mbeturinave dhe rivitalizimit të tokës	197	197	210	214	219	360	361	/
	Ndërtimtari	216	221	227	275	360	319	329	/
	Tregti me shumicë e pakicë, riparim veturash dhe motoçikletash	218	207	206	252	274	305	305	/
	Transportim e depozitim	257	260	262	263	263	366	379	/
	Aktivitete akomodimi dhe shërbimi ushqimor	208	217	221	220	269	266	265	/
	Informim e telekomunikim	776	782	792	829	852	707	708	/
	Aktivitete të tjera	235	238	255	302	334	273	293	/

Me qëllim të plotësimit të informacionit të deritashëm kemi vendosur të bëjmë një vlerësim të nivelit të performancës së vendit në lidhje me zhvillimin e ndërmarrësisë. Në këtë pjesë, kemi grupuar treguesit në katër kategori: Numri i ndërmarrjeve për sektor, numri i punëtorëve për aktivitet të sektorit ekonomik, paga mesatare për sektor ekonomik dhe aktiviteti sektorial.

Ajo që kemi arritur të nxjerrim nga gjetjet ishte që numri më i madh i ndërmarrjeve në Kosovë më 2014 ishin në tregti me shumicë e pakicë, riparime veturash e motoçikletash (16,142), pasuar nga prodhimtaria (4,052) si dhe aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (3,360). Gati e ngjashme ishte edhe gjendja në vitin bazë 2008. Kjo gjithashtu i përgjigjet gjetjeve të mëhershme që sektori tregtar është sektori më dominues në ekonominë e Kosovës.

Në anën tjetër, kemi hulumtuar edhe më tutje për të parë se cili sektor kompenson më së shumti punëtorët e tij. Siç mund të shohim nga të dhënat e paraqitura më lart, është sektori i informimit dhe telekomunikacionit ai që kompenson punëtorët e tij me pagë mesatare prej 708 € bruto (2014), pasuar nga sektori i furnizimit të energjisë elektrike, gazit, avullit dhe kondicionimi i ajrit, me mesatare prej 610 € bruto, si dhe sektori i minierave dhe gurthyesve me mesatare prej 470 € bruto. Kjo renditje e sektorëve në kuptimin e pagës mesatare për aktivitet të sektorit ekonomik është gjithashtu reflektim i pastër i faktit që këta tre sektorë janë në fakt sektorët më strategjikë për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ndërkohë, pagat mesatare janë ulur në krahasim me vitin bazë, derisa renditja ishte e ngjashme edhe atëherë, që edhe një herë rithekson rëndësinë strategjike të këtyre sektorëve për performancën e përgjithshme ekonomike dhe kontributin e tyre në këtë drejtim.

## Detyrimet dhe Tatimet

Treguesit ekonomikë		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifat (milione €)	TVSH	/	75,825,276	95,056,532	121,437,993	131,394,869	149,184,989	136,939,023	153,877,977
	Tatimi në të ardhura personale	/	39,227,003	44,208,930	55,668,304	87,365,088	90,342,564	65,818,313	74,639,926
	Tatimi në korporata	/	55,355,226	51,945,804	54,564,163	65,138,976	65,924,379	100,937,655	103,763,147
	Tatimi i paragjykuar	/	2,793,667	283,649	868,983	409,839	70,831	157,832	8,602
	Tatimi në fitim	/	8,407,044	582,999	1,792,756	117,480	163,273	15,513	672
	Tatimi në pronë	1.8	2.9	1.6	1.4	1.7	1.6	12.2	/
Doganat	Detyrime importi (milione €)	93.1	98	103.9	121	117.2	119.1	125.6	/
	Akciza								

Tatimet dhe doganat përfaqësojnë një rrjedhë të rëndësishme hyrëse në buxhetin e vendit. Në Kosovë, aktualisht kategoritë e detyrimeve financiare dallojnë, por kemi zgjedhur një numër prej 7 treguesve fiskalë për të matur nivelin e performancës së vendit në këtë fushë.

Ajo çka mund të vërejmë nga tabela më lart është se ka një ngritje të vazhdueshme të të hyrave nga tatimet në buxhetin e Kosovës.

Krahasuar me vitin bazë, përveç tatimit të paragjykuar, kemi një rritje pothuajse të dyfishtë në të gjitha kategoritë tjera. Në këtë mes, shihet qartë që TVSH-ja është kontribuuesja më e rëndësishme e të ardhurave fiskale në vend. Krahasuar me vitin 2008, niveli i TVSH-së së vjelë është rritur. Vlerësohet që në vitin 2015, të hyra nga TVSH ishin përafërsisht 75 milionë €, që është shumë gati dyfish më e lartë se shuma prej përafërsisht 76 milionë € në 2014.

Rritja e të hyrave nga TVSH-ja është edhe një arsyetim në vete i rënies së të hyrave nga tatimi i paragjykuar. Në anën tjetër, rrjedhat hyrëse buxhetore nga tatimi në të ardhura personale më 2015 ishin vlerësuar të jenë përafërsisht 154 milionë €.

I njëjti trend dominon edhe në rastin e tatimit në korporata dhe tatimit në pronë. Shihet qartë që mbledhja e tatimeve në pronë shënon një rritje të konsiderueshme. Niveli i tatimit në pronë të mbledhur është rritur për gati 12 herë në krahasim me vitin bazë. Derisa të hyrat tatimore nga prona janë vlerësuar në shifrën prej 1.8 milionë € më 2008, ato kanë arritur 12.2 milionë € më 2014.

Përfundimisht, detyrimet e importit, siç mund të pritët, duke marrë parasysh bilancin tejet negativ tregtar, janë kontribuuese madhore të buxhetit vendor. Ato janë rritur nga 93.1 milionë € më 2008 në 125.6 milionë € më 2014. Ky është konfirmim shtesë i faktit që niveli i importeve është rritur në masë të konsiderueshme përgjatë periudhës së studimit.

## Energjia

Treguesit ekonomikë		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shfrytëzimi i energjisë	Konsumi vjetor i energjisë (GWh energji elektrike)	/	3,200.7	3,480.3	3,684.9	3,611.6	3,705.6	3,772.0	3,971.9
	Hisja e konsumit të burimeve të ripërtërishme energjetike (duke përfshirë hidron)	0	0	0	0	0	0	0	0
	Intensiteti i përdorimit të energjisë (MJ/\$2011 PPP BPV)	7.06	7.53	7.48	7.25	6.61	/	/	/
Përdorimi i energjisë sipas sektorit	Household (GWh Energji elektrike)	/	1,768.7	1,873.2	2,007.7	2,084	2,130.2	2,050.3	2,113.7
	Industry (GWh Energji elektrike)	/	227.5	226.6	244.4	240.9	239.4	229.8	262.7
Prodhimi i energjisë	Kosova A (GWh Energji elektrike)	1,197	1,424	1,685	1,922	1,840	1,907	1,432	1,804
	Kosova B (GWh Energji elektrike)	3,254	3,252	3,195	3,140	3,378	3,812	3,310	3,557
	Hidro (GWh Energji elektrike)	76	122	158	105	96	143	102	142
	Biomasë (GWh Energji elektrike)	/	/	/	/	/	/	/	/
	Diellore (GWh Energji elektrike)	/	/	/	/	/	/	/	/
	Erë (GWh Energji elektrike)	/	/	/	/	/	/	/	/

Seksioni përfundimtar i analizës sonë ka të bëjë me zhvillimet në sektorin e energjisë. Nisur nga fusha primare e fokusit të punës sonë, që është monitorimi dhe kontributi drejt progresit të shënuar në këta sektorë, kemi vendosur të ndajmë një pjesë të posaçme për performancën e këtij sektori në Kosovë.

Siç mund të kuptohet nga tabela, konsumi i përgjithshëm vjetor i energjisë për vitin 2015 ishte 3971.9 GWh, që është gati 500 GWh më i lartë në krahasim më vitin bazë. Derisa kjo mund të jetë për shkak të integritit më të mirë të ekonomive familjare në rrjet, është gjithashtu pasojë e drejtpërdrejtë e efikasitetit të ulët në rrjet dhe konsum. Sa i përket intensitetit të përdorimit të energjisë, të dhënat e fundit të disponueshme janë ato të vitit 2012, kur ishte intensiteti shënuar 6.61 MJ.

Në kuptimin e përdorimit të energjisë sipas sektorëve, shohim një dominim të qartë të sektorit amvisnor. Më 2015, konsumi amvisnor shkonte deri në 2113.7 GWh derisa sektori industrial konsumonte një masë modeste prej 262.7 GWh – tipike për një vend me zhvillim të dobët industrial.

Në anën tjetër, sa i përket prodhimit të energjisë, qymyri vazhdon të jetë burimi kryesor, i cili përdoret për prodhimin e rrymës nga Kosova A dhe B. Këto dy termocentrale ishin burimi kryesor i energjisë elektrike në vitin 2015, duke mbuluar kështu 98% të prodhimit në Kosovë. Ndërsa energjia e prodhuar nga termocentralet perbën 2% të totalit apo 142 GWh.

Këto shifra vërtetojnë faktin që sektori i energjisë në Kosovë bazohet pothuajse tërësisht në prodhimin e energjisë nga qymyri dhe shquhet për mungesë të performancës në fushën e efijencës së energjisë dhe prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

## Rekomandime

Përgjatë hulumtimit tonë, jemi përballur me kufizime të caktuara në grumbullimin e të dhënave. Për këtë arsye, kemi rreshtuar një sërë rekomandimesh që po ia adresojmë të gjitha agjencive publike, ministrive përkatëse dhe Agjencisë Statistike të Kosovës. Duke qenë të fokusuar tek ofrimi i informatave të plota dhe të azhurnuara ashtu që politikë-bërësit dhe hartuesit e strategjive të marrin vendime të informuara, do të ishte e këshillueshme që:

- Agjencia Statistike e Kosovës të rishikojë tërësinë e vet të publikimeve, si dhe të sigurojë që databazat të jenë të plota me të dhënat e munguara;
- Agjencia Statistike e Kosovës të angazhohet në të siguruarit që të dhënat tremujore të sigurohen për të gjithë sektorët, si dhe jo vetëm për një numër të kufizuar të tyre, siç është situata sot;
- Agjencitë e pavarura të publikojnë raportet e tyre vjetore të të dhënave në baza të rregullta në faqet e tyre përkatëse të internetit;
- Ministrinë të kërkojnë llogari nga agjencitë kur këto të dhëna nuk vihen në dispozicion të publikut me qasje të lehtë;
- Qeveria të kërkojë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës që të plotësojë listën e treguesve, duke inkorporuar të gjithë treguesit e sugjeruar sipas metodologjisë që ofrohet nga OKB-ja;
- Agjencia Statistike e Kosovës të bashkëpunojë me databazat tjera të mëdha statistikore ndërkombëtare, si ato që janë përdorur për përpilimin e të dhënave në këtë platformë të TZHQ-ve.